

DREJTËSIA SOT

Analizë e shkurtër e Drejtësia Sot

(Qershor 2019 - Shtator 2019)

DUKE VEPRUAR NË ERRËSIRË: NJË ANALIZË PËR ZHVILLIMET E FUNDIT NË SISTEMIN E DREJTËSISË NË KOSOVË



DREJTËSIA SOT



Analizë e shkurtër e Drejtësia Sot

(Qershor 2019 - Shtator 2019)

DUKE VEPRUAR NË ERRËSIRË: NJË ANALIZË PËR ZHVILLIMET E FUNDIT NË SYSTEMIN E DREJTËSISË NË KOSOVË

Projekti “Monitorimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë”, përkrahet financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës së saj në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës së saj në Prishtinë.

DUKE VEPRUAR NË ERRËSIRË: NJË ANALIZË PËR ZHVILLIMET E FUNDIT NË SISTEMIN E DREJTËSISË NË KOSOVË

HYRJE

Sistemi gjyqësor paraqet bazamentin kryesor të një shoqërie demokratike. Gjyqësia transparente, e përgjegjshme dhe efikase promovon mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe u ofron qytetarëve një qasje të drejtë dhe efektive në drejtësi.

Nepotizmi, paanshmëria e gjyqësorit, shkeljet e ligjit nga gjyqtarët dhe prokurorët, procedurat e gjata në zgjidhjen e çështjeve të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, mos shqiptimi i denimeve apo denimet e lehta për rastet e korrupsionit të rëndë, janë vetëm disa karakteristika që vazhdojnë të e dobësojnë sistemin gjyqësor të Kosovës. Për më tepër, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), si institucione kryesore përgjegjëse për mbikëqyrjen e pavarësisë, paanshmërisë dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, nuk kanë treguar gjithmonë sukses në përmbushjen e detyrave të tyre siç kërkohet nga Kushtetuta dhe ligjet në fuqi.

Platforma 'Drejtësia Sot' gjatë muajve qershor - shtator të vitit 2019, ka monitoruar nga afër institucionet të cilat sigurojnë që dega e gjyqësorit ruan dhe promovon një standard që i shërben drejtësisë së të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mbështet respektimin e të drejtave të njeriut, të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Më konkretisht, Drejtësia Sot ka monitoruar nga afër punën e përgjithshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK-së) dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK-së). Kjo platformë bën monitorimin nga afër të mbledhjeve të tyre dhe proceseve të hartimit të politikave, të emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, abuzimet e mundshme në detyrat e tyre zyrtare, masat e ndërmarra disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve që kanë bërë shkelje gjatë ushtrimit të detyrës, trajtimit të rasteve të caktuara të korrupsionit si dhe rasteve të krimit të organizuar.¹

Për më tepër, Drejtësia Sot ka monitoruar nga afër seancat gjyqësore të të gjitha gjykatave në tërë Kosovën, veçanërisht të departamenteve që merren me krime të rënda, korrupsion dhe krim të organizuar. Drejtësia Sot përpiket të vë në qendër të vëmendjes rastet e profileve të larta të korrupsionit të cilat kërkojnë veprim të menjëhershëm nga institucionet gjyqësore të Kosovës.²

Kjo analizë paraqet analizën e parë të trajtimit të disa prej rasteve të profilit të lartë nga gjykatat dhe prokuroritë në Kosovë. Njëkohësisht paraqet veprimet të cilat KGJK dhe KPK si institucione kushtetuese në sigurimin dhe mbikëqyrjen e pavarësisë, paanshmërisë dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, kanë dështuar të ndërmarrin.

¹ GLPS ka formuar platformën 'Drejtësia Sot', nën mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme në Mbretërinë e Bashkuar përmes Ambasadës së saj në Prishtinë, e cila ofron informacione të hollësishme, të besueshme dhe të dorës së parë lidhur me rastet e korrupsionit, krimin e organizuar dhe çështjet gjyqësore të profileve të larta.

² Raportet ditore të aktiviteteve të monitorimit publikohen në platformën ROLPIK të GLPS /Drejtësia Sot, <http://www.rolpik.org/>

1. KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

1.1 Procesi i Emërimit Të Gjyqtarëve Në Departamentin Special

1.1.1. Emërimi i dyshimtë i gjyqtarëve të Departamentit Special: Një proces i fshehtë dhe i mbajtur larg syve të publikut

Departamenti Special është themeluar në korrik të vitit 2019, përmes ligjit për Gjykatat, nr. 06/L – 054. Ky departament funksionon brenda Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Gjykatës së Apelit, si nevojë për ta rritur efikasitetin në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.³

Departamenti Special i Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Gjykatës së Apelit ka të drejtë të gjykojë çështjet që janë në kompetencën e Zyrës së Prokurorisë Speciale.⁴ Ndërkohë, neni 4 i Ligjit nr.03/L-052 për Zyrën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) përcakton kompetencën ekskluzive të PSRK-së për hetimin dhe ndjekjen penale të krimit të organizuar. Ky provision e zgjeron juridiksionin e kësaj Prokurorie në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.⁵ Me fjalë të tjera, Departamenti Special i Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Gjykatës së Apelit do të kenë kompetencën ekskluzive për të gjykuar rastet e krimit të organizuar në të gjithë territorin e Kosovës.

KGJK-ja në korrik të vitit 2019 ka emëruar nëntë (9) gjyqtarë në Departamentet Speciale; gjashtë (6) gjyqtarë në Departamentin Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe tre (3) gjyqtarë në Departamentin Special të Gjykatës së Apelit.⁶ Duke pasur parasysh ndjeshmërinë dhe natyrën e fushës së punës së këtij departamenti dhe rolin e gjyqtarëve të emëruar në gjykimin e çështjeve të profilit të lartë të krimit të organizuar, Drejtësia Sot e ka konsideruar të nevojshme që procesi i emërimit të monitorohet nga afër. Megjithë kërkesën e vazhdueshme të Drejtësia Sot për të monitoruar procesin e emërimit të gjyqtarëve për këtë departament, KGJK-ja vendosi t'i mbajë organizatat e shoqërisë civile larg këtij procesi. Për më tepër, KGJK-ja asnjëherë nuk e bëri të ditur për publikun metodologjinë e përdorur për përzgjedhjen e kandidatëve të emëruar.

Si rrjedhojë, Drejtësia Sot ka bërë një kërkesë për të pasur qasje në dokumente publike, përkatësisht në kriteret/metodologjinë e përdorur për të vlerësuar kompetencën dhe profesionalizmin e kandidatëve për poste të tilla.⁷ Megjithatë, KGJK-ja ka qëndruar e heshtur dhe nuk i është përgjigjur kërkesës së paraqitur nga Drejtësia Sot. Për më tepër, ajo nuk ka ndarë asnjë informacion mbi procesin dhe metodologjinë e përzgjedhjes së kandidatëve në listën e ngushtë.⁸ Duhet të theksohet se kategoria e të dhënave të kërkuara nga Drejtësia Sot nuk i përket informatave konfidenciale, por atyre publike. Një veprim i tillë i KGJK-së vë në dyshim motivin e vërtetë pas këtij procesi të mbajtur me dyer të mbyllura, larg syve të publikut.

³ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 06/ L-054 mbi Gjykatat, neni 13 and neni 24, burimi: <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302>

⁴ Id. tek neni 18.

⁵ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03 / L-052 mbi Zyrën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës

⁶ Drejtësia Sot, “Emërohen udhëheqësit e Departamentit Special në Gjykatën Themelore”/ (01.08.2019) burimi: <http://www.rolpik.org/emerohen-udheheqesit-e-departamentit-special-ne-gjykatën-themelore-ne-prishtinë-dhe-gjykatën-e-apelit/>

⁷ Id.

⁸ Id.

KGJK-ja me një veprim të tillë, ka shkelur rëndë parimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë, parim i cili duhej të respektohej gjatë këtij procesi. Duhet patur parasysh se gjatë procesit të emërimit të gjyqtarëve në një departament që do të trajtojë raste të ndjeshme të krimit të organizuar, shqyrtimi publik është një domosdoshmëri për të parandaluar abuzimet e mundshme dhe arbitraritetin gjatë procedurës së emërimit.

Aktualisht, Drejtësia Sot ka ngritur një padi kundër KGJK-së për shkeljen e Ligjit Nr. 03 / L-215 për Qasje në Dokumente Publike. Mbetet të shihet se si do ta gjykojë Departamenti Administrativ i Gjykatës Themelore në Prishtinë si dhe nëse sistemi ynë gjyqësor ofron mjetet e nevojshme për të siguruar që e drejta për qasje në dokumentet publike nuk çënohet, aq më tepër nga një institucion i mandatuar nga Kushtetuta për të mbikëqyrur dhe menaxhuar punën e gjyqësorit në Kosovë.

1.1.2 Shkelja e parimit të bazuar në meritë: Emërimi i gjyqtarëve pa merita

Sipas nenit 30 të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat, për të shërbyer si gjyqtar në Departamentin Special, kandidati duhet të plotësojë kushtet për të punuar si gjyqtar në Departamentin e Krimeve të Rënda dhe të ketë një vlerësim pozitiv të performancës.

Duke pasur parasysh që KGJK-ja nuk e ka aprovuar kërkesën e Drejtësia Sot për qasje në të dhëna publike dhe për shkak të mungesës së transparencës që ka përshkruar këtë proces, të dhënat e vetme publike mbi emërimin e gjyqtarëve janë informatat e përgjithshme të dhëna në faqen e internetit të gjykatës dhe ato raportuara nga mediat. Vlerësimet paraprake të Drejtësia Sot bazuar në profilet publike të gjyqtarëve të emëruar, nxjerrin në përfundim se KGJK-ja ka emëruar një numër gjyqtarësh që nuk kanë përmbushur kushtet e përcaktuara në ligji dhe rregullore. Bazuar në të dhënat e gjyqtarëve dhe ato të publikuara në faqen e gjykatës, gjyqtarët e emëruar nuk kanë gjykuar asnjë çështje të profilit të lartë ose ndonjë çështje që është në kompetencën e departamentit të krimeve të rënda.⁹ Këto informata sugjerojnë që disa prej tyre, nëse jo të gjithë, nuk i kanë përmbushur kushtet për t'u caktuar si gjyqtarë në Departamentin Special. Megjithatë KGJK-ja ka bërë emërimin e tyre.

Serioziteti dhe rëndësia e çështjeve që janë në kompetencën e departamenteve speciale kërkojnë përvojë dhe profesionalizëm të shkëlqyeshëm të gjyqtarëve. Në përputhje me këtë, neni 5 i Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Departamentit Special brenda Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Gjykatës së Apelit shprehet se në mesin e shumë kushteve për të punuar si gjyqtarë në Departamentin Special, kandidati duhet të tregojë gjithashtu kapacitete të dëshmuara për të përpiluar arsyetim ligjor.¹⁰ Prandaj, në mënyrë që gjyqtarët të kryejnë detyrat e tyre në përputhje me rrethanat, Drejtësia Sot konsideron se KGJK-ja duhet të ketë analizuar aktgjykimet e tyre të kaluara, ashtu që të vlerësojë kapacitetet e tyre të dëshmuara për përpilimin e arsyeimeve ligjore.

1.2 Mosndëshkimi i gjyqtarëve që kanë shkelur ligjin nga KGJK-ja

Detyra e një gjykatësi është të veprojë në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, si dhe të nxjerrë aktgjykim në përputhje me ligjin. Etika profesionale dhe përgjegjësia e gjyqtarëve në Kosovë

⁹ Koha.net, 'Rastet më të rënda në dorë të gjyqtarëve të zgjedhur në mjegull/ (09.09.2019), burimi: <https://www.koha.net/arberi/183192/rastet-me-te-renda-ne-dore-te-gjyqtareve-te-zgjedhur-ne-mjegull/?fbclid=IéAR1xAKOlrDi7ki2yl-zvOUzChog9vK3kx1eTaN9kXdKdVHXQoxdzRXi-l>

¹⁰ Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Rregullorja nr. 03/2018 për Organizimin dhe Funksionimin e Departamentit Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe Gjykatën e Apelit, neni 5.5.

rregullohet me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarët, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe me Rregulloren në fuqi.

Njëra ndër masat më të rënda që mund të i ndërmarrë KGJK-ja është t'i propozojë Presidentit shkarkimin e gjyqtarëve pasi të jetë marrë një vendim gjyqësor i formës së prerë për dënimin e një gjyqtari ose prokurori. Megjithatë, në shumë raste si më poshtë, KGJK-ja nuk ka ndërmarrur asnjë hap kundër gjyqtarëve që dyshohet se kanë kryer shkelje gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe që të njejtit gjatë ushtrimit të detyrës së tyre kanë shkelur ligjin penal material.

Një veprim i tillë i KGJK-së paraqet dështimin dhe neglizhencën totale të këtij institucioni karshi shkeljeve të vërtetuara nga Gjykata Supreme të ligjit penal dhe material. Rikujtojmë që KGJK-ja është institucioni i vetëm me kompetencën e disiplinimit të gjyqtarëve në Republikën e Kosovës. Për më tepër, KGJK-ja ka rolin kryesorë në sigurimin e një gjyqësori të drejtë, të pavaruar dhe të paanshëm dhe çdo dështim i kryerjes së veprimeve konkrete në këtë aspekt dëmton rëndë sistemin gjyqësor dhe mirëqenien e të gjithë qytetarëve në vend.

1.2.1. Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore

Kodi Penal i Kosovës (KPRK) dhe Konventa Evropiane parashikojnë që nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore përbën një vepër penale të dënueshme me burgim efektiv.¹¹ Fatkeqësisht në Kosovë, në një numër të madh të çështjeve, gjyqtarët nxjerrin aktgjykime të formës së prerë duke shkelur rëndë ligjin. KGJK-ja deri më tani nuk ka marrë asnjë masë për t'i adresuar shkeljet e gjyqtarëve gjatë procedurave gjyqësore të cilat janë vërtetuar me vendime të Gjykatës Supreme në rastin e z. Emin Beqiri (PML-nr.341/2018)¹² dhe z. Sali Mekaj (PML-nr.36/2019)¹³. Njëkohësisht, vendimet e të dy rasteve të cilat janë konsideruar të jenë në shkelje të ligjit penal material janë vendime të marra nga gjyqtari Fillim Skoro dhe Driton Muharremi, gjyqtarë pjesë të paneleve gjyqësore të Gjykatës së Apelit në dy rastet konkrete.

Rasti 'Salih Mekaj'

Z. Salih Mekaj, ish-kryetari i Gjykatës së Apelit, ishte i akuzuar për veprën – Keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422, dhe Krim të organizuar nga Kapitulli XXIV i KPRK-s. Gjatë procesit gjyqësor, Prokuroria kishte ndryshuar aktakuzën, ashtuqë, i'a kishte ricilësuar veprën penale nga vepra e keqpërdorimit e përcaktuar me nenin 422 par 1.të KPRK-së, në vepër penale të ushtrimit të ndikimit sipas nenit 431.par.1.të KPRK-së. Ish-kryetari i Gjykatës së Apelit, dyshohej të ishte i angazhuar në caktimin gjyqësor të dy rasteve gjyqësore dhe ricilësimin juridik të veprave penale për këto raste. Gjykata Themelore në Prishtinë liroi ish-kryetarin e Gjykatës së Apelit, z. Salih Mekaj dhe të akuzuarit e tjerët me arsyetimin se sipas gjetjeve të gjykatës së shkallës së parë, e të vërtetuara më pas nga shkalla e dytë, kontaktet e të pandehurit Salih Mekaj me të pandehurën V.G. nuk kanë paraqitur vepër penale por shkelje të Kodit të Etikës. Ndërsa ato me gjyqtaren L. M. kanë qenë të lejuara për arsye se kryetari i Gjykatës së Apelit ka për detyrë të interesohet për lëndët në të cilat

¹¹ Kuvendi i Kosovës, Kodi Penal i Republikës së Kosovës NR. 06 / L-074425, neni 425.

¹² Gjykata Supreme e Kosovës, rasti: PML. 341/2018, vendim i datës 1 prill 2019.

¹³ Gjykata Supreme e Kosovës, rasti: PML, nr.36/2019, vendim i datës: 05 Qershor 2019

paraburgimi është i stërzgatur.¹⁴ Prokurori paraqiti një ankesë në Gjykatën e Apelit, dhe Gjykata e Apelit e vërtetoi vendimin e Gjykatës Themelore duke shpallur z. Sali Mekaj dhe të tjerët të pafajshëm.

Gjykata e Apelit me këtë aktgjykim ka konstatuar se në aktgjykimin e atakuar nuk evidentohen shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Poashtu, sipas kësaj gjykate gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, dhe si pasojë nuk ka shkelje as të ligjit penal.¹⁵

Si rrjedhim, prokurori i çështjes paraqiti ankesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës. Gjykata Supreme konstatoi se pafajësia e shpallur e z.Salih Mekaj paraqiste shkelje ligjore. Sipas Gjykatës Supreme, aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Gjykatës së Apelit, lidhur me të pandehurin z. Salih Mekaj për veprën penale 'ushtrimi i ndikimit', paraqesin shkelje të kodit penal.¹⁶ Megjithatë, asnjë veprim i mëtutjeshëm nuk është ndërmarrë as nga Gjykata Supreme dhe as nga ajo e Apelit.¹⁷

KGJK-ja deri më tani nuk ka ndërmarrë asnjë masë për të ndaluar këto praktika të paligjshme të gjyqtarëve duke i lënë ata të pandëshkuar edhe pse për të njejtë Gjykata Supreme ka vendosur që e kanë shkelur ligjin penal. Për këtë arsye, Drejtësia Sot konstaton se KGJK-ja duhet të ndërmarrë masa specifike kundër gjyqtarëve pjesëmarrës në nxjerrjen e aktgjykimeve joligjore në këtë çështje. KGJK-ja është institucion i mandatuar nga ligjet në fuqi si autoriteti kompetent për disiplinimin e gjyqtarëve në raste të tilla. Andaj, dështimi i KGJK-së në ndërmarrjen e hapave konkret dhe fillimin e procedurave disiplinore ndaj gjyqtarëve të cilët kanë vendosur në këtë rast është dështim i tërë sistemit të drejtësisë në luftimin e krimit dhe korrupsionit të profilit të lartë.

Rasti 'Emin Beqiri'

Në këtë çështje penale kemi të bëjmë me një aktakuzë të ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ndaj z. Emin Beqirit, ish-shefit të krimeve ekonomike në Policinë e Kosovës. Ai akuzohej për tri veprave penale; (1) keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar sipas nenit 422.1 i KPK-së, (2) pengim i të provuarit sipas nenit 394 par.2 i KPK-së dhe (3) moslajmërim i veprave penale apo kryesve të tyre sipas nenit 386 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së. Po ashtu, i akuzuar në këtë çështje penale ishte edhe z. Rrahim Hashimi. Ky person përmes kësaj aktakuze, akuzohej se ka kryer dy vepra penale; (1) ushtrim i ndikimit sipas nenit 431 par.1 të KPK-së dhe (2) mashtrim në vazhdim sipas nenit 335 par.1 lidhur me nenin 81 të KPK-së. Kundër kësaj aktakuze mbrojtësit e të pandehurve në fjalë kishin paraqitur kundërshtimet e tyre në Gjykatën Themelore të Prishtinës, e cila me aktvendimin e datës 25.06.2018, i ka refuzuar kërkesat për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave për të.

Mirëpo, gjërat ndryshuan në momentin kur Gjykata e Apelit, duke vendosur mbi ankesat e mbrojtjes së të pandehurve të paraqitura ndaj aktvendimit të Gjykatës Themelore, i kishte aprovuar pretendimet

¹⁴ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës në çështjen Salih Mekaj (2017), Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në çështjen Salih Mekaj PML. 36/2019

¹⁵ Gjykata e Apelit të Kosovës, "PAKR.nr.476/2018", të datës 23.10.2018.

¹⁶ Vendimi i Gjykatës Supreme për rastin e Salih Mekajt (Qershor 2019); Komunikatë për shtyp, (24.96.2019), burimi: <https://kallxo.com/uncategorized/gjykatesit-qe-e-liruan-sali-mekaj/>

¹⁷ Konstatimi i thjeshtë i shkeljeve ligjore nuk është masa e duhur për të arritur qëllimin e dënimit juridik siç kërkohet nga kushtetuta, duke e lënë të lirë të pandehurin pa asnjë pasojë edhe pse është liruar kundërligjshëm. Prandaj, Drejtësia Sot kërkon që çështja e z.Salih Mekajt të rigjykohet nga Gjykata e Apelit dhe të eliminohen të gjitha shkeljet e ligjit.

e mbrojtjes së të pandehurit Emin Beqiri.¹⁸ Në këtë mënyrë, Gjykata e Apelit përmes këtij vendimi kishte ndryshuar aktvendimin e shkallës së parë, ashtu që, ndaj të pandehurit Emin Beqiri kishte hedhur aktakuzën për veprat penale si më lartë dhe në këtë mënyrë kishte pushuar procedurën penale që po zhvillohej ndaj tij. Të gjitha këto veprime ishin arsyetuar me faktin që sipas kësaj gjykate nuk kishte prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprat penale për të cilat dyshohej. Me të njëjtin aktvendim, Gjykata e Apelit duke vepruar sipas detyrës zyrtare dhe duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të Rrahim Hashimi, e kishte anuluar aktvendimin e shkallës së parë dhe çështjen e kishte kthyer në rivendosje.¹⁹

Në rivendosje, Gjykata Themelore e Prishtinës, me aktvendim përsëri e kishte refuzuar kërkesën e mbrojtësit të Rrahim Hashimit për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave kundër tij. Kundër këtij aktvendimi të Gjykatës Themelore, mbrojtësi i të pandehurit Rrahim Hashimi kishte paraqitur ankesë në Gjykatë të Apelit. Kjo ankesë ishte aprovuar pjesërisht nga Gjykata e Apelit me aktvendimin e datës 21.09.2018, ashtuqë Gjykata e Apelit, sipas detyrës zyrtare kishte ndryshuar vendimin e shkallës së parë duke aprovuar kërkesën e mbrojtjes së të pandehurit.²⁰ Me anë të këtij aktvendimi, Gjykata e Apelit kishte pushuar procedurën penale për veprën penale ushtrimi të ndikimit me arsyetimin se nuk është vërtetuar se i njëjti e ka kryer këtë vepër. Ndërsa, për veprën penale të mashtrimit në vazhdim është refuzuar ankesa e mbrojtjes dhe procedura është vazhduar me caktimin e shqyrtimit gjyqësor.

Në rastin në fjalë, kemi të bëjmë me dy aktvendime të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me të cilat janë pushuar procedurat penale ndaj dy të akuzuarve Emin Beqiri dhe Rrahim Hashimi. Respektivisht, me vendimet e atakuara, Gjykata e Apelit ka hudhur poshtë aktakuzën kundër Emin Beqiri me arsyetimin se nuk ka prova të mjaftueshme se i njëjti ka kryer këto vepra penale si dhe, me aktvendimin e datës 21.09.2018, Gjykata e Apelit me arsyetimin e njëjtë si ndaj të pandehurit Emin Beqiri, ka pushuar procedurën për Rrahim Hashimin për veprën penale të ushtrimit të ndikimit.

Kundër këtyre aktvendimeve, Prokuroria e Shtetit ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë të bazuar në nenin 438 par.2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.²¹

Pra, Gjykata Themelore e Prishtinës vendosi kundër të pandehurve dhe i shpalli fajtorë.²² Por, i pandehuri Emin Beqiri paraqiti ankesë. Gjykata e Apelit pranoi ankesën e avokatit mbrojtës të Emin Beqirit, dhe ndryshoi aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë duke e hedhur aktakuzën kundër Beqirit dhe përfunduar procedurën penale kundër tij, ndërsa kundër të akuzuarit tjetër, z. Rrahim Hashimit, Gjykata e Apelit e kishte kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën Themelore në Prishtinë.²³

Gjykata Supreme e Kosovës, bazuar në kërkesën e parashtruar nga Prokurori i Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktvendimeve të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Gjykatës së Apelit, konstatoi se të dy Gjykatat kanë shkëlur kodin penal në favor të të pandehurit.

¹⁸ Gjykata e Apelit të Kosovës, aktvendim PN.nr.681/2018 i datës 18.09.2018

¹⁹ Gjykata e Apelit të Kosovës, aktvendim PN.nr. 1014/2018, vendim i datës 18.10.2018.

²⁰ Gjykata e Apelit të Kosovës, aktvendim PN.nr. 1014/2018, vendim i datës 18.10.2018.

²¹ Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, KMPLP.I.nr.24/18, e datës:15.02.2019.

²² Aktgjykimi i Gjykatës Themelore për rastin e *Emin Beqirit*.

²³ Kallxo.com, Komunikatë për shtyp, (17.94.2019), burimi: <https://kallxo.com/shkurt/gjykata-supreme-vendimi-i-apelit-i-beri-favore-emin-beqirit/>

Sidoqoftë, ngjashëm me rastin e Mekajt, KGJK-ja nuk ka marrë masa ndaj gjyqtarëve që kanë shqiptuar aktgjykime joligjore. Si rezultat i këtyre praktikave të mosndëshkimit, të njejtit gjyqtarë janë ende pjesë e sistemit. Të njejtive nuk iu është shqiptuar asnjë masë disiplinore dhe të njejtit janë ende pjesë e paneleve gjyqësore në Gjykatën e Apelit. Një praktikë e këtillë e pandëshkueshmërisë, e instaluar nga KGJK-ja, tregon qartë neglizhencën dhe dështimin e KGJK-së në trajtimin e thelbit të problemit të sistemit të drejtësisë, atë të mosndëshkimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

2. KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS

2.1 Emërimi i paligjshëm i Ushtruesit të Detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë: Shkelje e rregullores në fuqi

Drejtësia Sot ka monitoruar nga afër procesin e emërimit të kryeprokurorëve të njësive përkatëse të prokurorisë në Kosovë. Përfshirë këtu edhe procesin e anuluar për emërimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale dhe të Ushtruesit të Detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

Ligji Nr.06/L –056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Ligji për KPK), parasheh që KPK-ja, si një organ kushtetues, vendos në mënyrë të pavarur emërimin e Kryeprokurorëve të Prokurorisë Themelore, Prokurorisë Speciale dhe të Apelit.²⁴ Si rezultat, procedura e emërimit të Kryeprokurorëve rregullohet vetëm me legjislacionin sekondar i cili është ndryshuar disa herë në vitet e fundit. Kjo praktikë ka shkaktuar pasiguri juridike dhe ka ndikuar ndjeshëm në procedurat e emërimit për pozicionet kryesore në degën e gjyqësorit.

Më 2016, KPK-ja ka miratuar Rregulloren Nr. 08/2016 për Emërimin e Kryeprokurorëve (Rregullorja 2016).²⁵ Kjo e fundit është ndryshuar dy herë gjatë vitit 2019. Një herë në muajin shkurt dhe një herë në muajin gusht.

Duhet të theksohet se njëra ndër arsyet se pse Rregullorja 2016 duhej të ndryshohej ishte që e njeta t'a pasqyrore qëllimin e Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (KI34 /17) mbi çështja e njohur si rasti 'Daka'.²⁶ Në këtë drejtim, Rregullorja 2016 nuk u siguronte të gjithë kandidatëve të drejtën për t'u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga Paneli Vlerësues (një organ i krijuar nga KPK-së) të cilit i takon e drejta për të kualifikuar apo diskualifikuar kandidatët bazuar në pikat e dhëna nga ky panel. Prandaj, një rregullore e re është dashur të hartohet nga KPK-ja në mënyrë që të përputhet me parimet e vendosura për rastin 'Daka'.

Përderisa Rregullorja 2016 ishte në process të plotësim - ndryshimit, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Prishtinës, z. Imer Beka, u pensionua me 15 qershor 2019 dhe si rrjedhojë Prokuroria Themelore e Prishtinës mbeti pa Kryeprokuror. Duke pasur parasysh se rregullorja e re e cila do të

²⁴ Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 06/L–056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

²⁵ Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), Rregullorja Nr. 08/2016 për Emërimin e Kryeprokurorëve.

²⁶ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese (KI34 / 17), ku Gjykata Kushtetuese vendosi të anulojë vendimin e KGJK për emërimin e z. Enver Peci si Kryetar të Gjykatës Supreme të Kosovës, sepse konstatoi se mekanizmi i votimit i zbatuar nga KGJK për kandidatët për të emëruar një kandidat për pozicionin e Kryetarit të Gjykatës Supreme nuk ka siguruar masat e nevojshme për të garantuar zbatimin e mjaftueshëm të parimeve të barazisë, transparencës dhe hapjes gjatë procesit të votimit. Si rezultat i këtij procesi të gabuar të votimit dhe jo-kohorent, të gjithë kandidatët u vendosën në një pozitë të pasiguritë juridike, pabarazisë dhe zgjedhjes jo-meritore, e gjeni në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14804>

rregullonte procedurën e emërimit të Kryeprokurorëve ende nuk ishte miratuar, KPK-ja nuk mund të emëronte Kryeprokurorin e ri të Prokurorisë Themelore në Prishtinë. Pavarësisht kësaj, në mbledhjen e 168-të të KPK-së, Kryesuesi, z. Hyseni, propozoi z. Kujtim Munishi, si Ushtrues i Detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë. KPK-ja e miratoi atë. Rrjedhimisht, derisa të emërohet kryeprokurori i ri i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, z. Munishi do të shërbejë si ushtrues i detyrës së kryeprokurorit të kësaj prokurorie. Në kohën e emërimit, z. Munishi ishte shef i Departamentit të Krimeve të Rënda në Prokurorinë Themelore të Prishtinës.²⁷

Rregullorja Nr. 01/2019 për ndryshimin e Rregullores Nr.08/2016 për Emërimin e Prokurorëve (rregullorja është ndryshuar përsëri me 1 gusht 2019), parasheh hapat që duhet të ndiqen kur një njësi prokuroriale mbetet pa kryeprokuror. Në nenin 14 të Rregullores Nr.08/2016 thuhet qartë se Kryeprokurori i njësisë përkatëse të Prokurorisë përcakton në pozitën e tij/saj, zëvendës prokurorin i cili e zëvendëson kryeprokurorin në rast të mungesës së tij. Për më tepër, specifikon që mandati i zv/kryeprokurorit mund të zgjasë jo më gjatë se tre muaj.²⁸

Megjithatë duke pasur parasysh parimin juridik "Lex posteriori derogate lex apriori"²⁹, Rregullorja Nr.08/2016 vazhdoi të mbetet në fuqi deri në miratimin e rregullores së re. Në kohën e emërimit të ushtruesit të detyrës së kryeprokurorit (qershor 2019), miratimi i rregullores së re u shty, ndërsa Rregullorja e vjetër 08/2016 për Emërimin e Kryeprokurorit vazhdoi të mbetet në fuqi.³⁰

Në këtë mënyrë KPK-ja ka shpërfillur plotësisht rregulloren në fuqi pasi ka emëruar z. Kujtim Munishin si Ushtrues i Detyrës së Kryeprokurorit, pavarësisht nga fakti se z. Kujtim Munishi nuk ka mbajtur detyrën e Zëvendës Kryeprokurorit por pozitën e Shefit të Departamentit të Krimeve të Rënda. Për më tepër, zëvendësi i z. Imer Beka ishte prokurori Ibrahim Berisha.³¹ Siç parashikohet nga rregullorja që ishte në fuqi, pozita e Ushtruesit të Detyrës së Kryeprokurorit do të duhej t'i takonte ligjërisht z. Ibrahim Berisha. Si rrjedhojë z. Ibrahim Berisha, të cilit sipas rregullores do të duhej t'i takonte pozita e zv. prokurorit, ngriti padi kundër vendimit të KPK-së. Kjo çështja është ende në procedurë pranë gjykatës.

Drejtesia Sot arriti në përfundim se emërimi i z. Kujtim Munishit nga KPK-ja ishte i kundërligjshëm dhe në kundërshtim me Rregulloren Nr. 08/2016 për Emërimin e Kryeprokurorit. Poashtu, pos shkeljeve ligjore të identifikuar në këtë proces, emërimi i z. Munishit është pritur me rezerva të mëdha nga qytetarët ngase z. Munishi në vitin 2017 ka mbyllur hetimin ndaj Kryeprokurorit të Shtetit, z. Alekandër Lumezi, gjë që vë në dyshim motivet e vërteta të emërimit të tij.

²⁷ Drejtësia Sot, Deklaratë për shtyp, (07.06.2019), burimi: <http://www.rolpik.org/raporti-i-takimit-te-168-te-te-keshillit-prokurorial-te-kosoves/>

²⁸ Rregullorja Nr. 08.2016 për Emërimin e Prokurorëve, neni 14.

²⁹ "Ligji i ri e shfuqizon ligjin e vjetër."

³⁰ Në kohën e emërimit të ushtruesit të detyrës së kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Prishtinës, Rregullorja Nr. 08/2016 - Për Emërimin e Kryeprokurorëve ishte ndryshuar në shkurt 2019. Sidoqoftë, neni 14 i Rregullores që parashikon procesin e caktimit të Zëvendës Kryeprokurorit ka mbetur i pa ndikuar nga ndryshimi. Prandaj emërimi i ushtruesit të detyrës së kryeprokurorit duhej të bazohej në Rregulloren e vitit 2006.

³¹ Drejtësia Sot, "Prokurori Kujtim Munishi vazhdon të mbetet ushtrues detyre i Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë", (04.07.2019), burimi: <http://www.rolpik.org/prokurori-kujtim-munishi-vazhdon-te-mbetet-ushtrues-detyre-i-kryeprokurorit-te-prokurorise-themelore-ne-prishtine/>

2.2 Dështimi i KPK-së në mbrojtjen dhe sigurimin e pavarësisë së prokurorëve: Rasti 'Veteranët'

Neni 3 i Ligjit Nr. 06/L- 056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës përcakton që KPK-ja është institucioni përgjegjës për sigurimin e një sistemi prokurorial të pavarur, profesional e të paanshëm. Poashtu, i njejtë nen përcakton që KPK-ja vepron në atë mënyrë që respekton dhe ruan pavarësinë e prokurorëve derisa ata kryejnë funksionet e veta të ndjekjes. Rrjedhimisht, KPK-ja është institucioni përgjegjës për sigurinë e secilit prokuror përgjatë kryerjes së punës së tij. Fatkeqësisht, rasti i cili trajtohet më poshtë tregon dështimin e KPK-së dhe neglizhencëm e aplikuar nga ky institucion ndaj prokurorit i cili ka hetuar rastin të njohur me emrin 'Veteranët' dhe të cilësuar si rasti më i madh i pasluftës.

Më 13 gusht 2018, prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, z. Elez Blakaj, u dorëhoq nga pozita e tij e prokurorit me arsyetimin se dorëheqja e tij vinte për shkak të presioneve politike dhe kërcënimeve të vazhdueshme gjatë hetimit të rastit të njohur me emrin 'Veteranët'. Ky rast cilësohet të jetë si njëri ndër rastet më të ndjeshme në territorin e Republikës së Kosovës meqë i njejtë përfshinë persona të profilit të lartë. Ndër ta ish komandantë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të UCK-së dhe persona të cilët mbajnë pozita të larta përfaqësuese shtetërore në Kosovë. I njejtë kishte bërë publik faktin që gjatë fazës së hetimit të rastit 'Veteranët', ku tashmë të akuzuar janë Agim Çeku, Nuredin Lushtaku, Sadik Halitjaha, Shkumbin Demaliaj, Qelë Gashi, Shukri Buja, Rrustem Berisha, Faik Fazliu, Smajl Elezaj, ai dhe familja e tij në vazhdimësi kanë qenë të kërcënuar. I njejtë ka deklaruar që puna e tij është tentuar të ndikohet nga veteranët e luftës, Kryeprokurori i Shtetit, z. Aleksandër Lumezi si dhe nga Kryeministri i Kosovës, z. Ramush Haradinaj.

Fatkeqësisht, ashtu siç është cekur më lartë, KPK-ja ka dështuar në rolin e saj primar. KPK-ja gjithashtu ka dështuar në sigurimin e pavarësisë së prokurorëve gjatë ushtrimit të profesionit të tyre në rastin konkret. Poashtu, mos marrja e masave konkrete ndaj personave për të cilët është raportuar që kanë ndërhyrë në punën e prokurorit të dorëhequr tregon qartë neglizhencën e KPK-së në luftimin e krimit dhe korrupsionit. Për më tepër, e njejtë me mos veprimin e saj ka krijuar një ambient të përshtatshëm për krime të tilla duke dërguar mesazhe të mos ndëshkueshmërisë për shkelësit e ligjit dhe mesazhe për mos-përkrahjen e punës së prokurorëve të guximshëm.

Një veprim i tillë, ka dëmtuar dhe ende vazhdon ta dëmtojë të gjithë sistemin e drejtësisë në Kosovë, përkatësisht sistemin prokurorial, meqenëse ende asnjë masë nuk është ndërmarrë lidhur me zbardhjen e akuzave dhe pretendimeve të ngritura nga prokurori Blakaj për ndërhyrjen në punën e tij nga Kryeprokurori i Shtetit, z. Aleksandër Lumezi si dhe nga Kryeministri i Kosovës, z. Ramush Haradinaj. Vlen të theksohet që përfshirja e këtyre figurave ose hapja e hetimeve dhe zhvillimi i procedurave ndaj të njejtëve, pa paragjykuar mbi fajësinë e tyre, do të dërgonte mesazh të qartë në gatishmërinë e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës për luftimin e krimit dhe korrupsionit.

2.3 Emërimi i Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë

Drejtësia Sot ka monitoruar procesin e vendosjes së bazës legislative për emërimin e kryeprokurorëve të njëjësive prokuroriale dhe Kryeprokurorit të Shtetit. Megjithëse ne vlerësojmë se KPK-ja ka hapur një

kanal mundësie të konsultimit me shoqërinë civile përmes disa takimeve gjatë hartimit të dokumenteve themeltare, në vlerësojmë që një konkluzion përfundimtar mbi integritetin e procesit të përzgjedhjes së kryeprokurorëve duhet bërë vetëm pasi që ai të përfundoj si i tërë, e jo në këtë fazë.

3. MONITORIMI I PUNËS DHE EFIKASITET TË GJYKATAVE DHE ZYRAVE TË PROKURORISË

3.1 Raste të caktuara të korrupsionit dhe të krimit të organizuar mbeten të pandëshkuara

Vazhdon të mbes çështje shqetësuese numri i madh i rasteve të caktuara të korrupsionit dhe krimit të organizuar nga zgjidhja e të cilave varet procesi i liberalizimit të vizave. Procedurat gjyqësore në raste të tilla përcjellen me vonesa të gjata, të cilat pengojnë procesin e zgjidhjes së lëndëve. Në këtë drejtim, mungesa e profesionalizimit të prokurorëve dhe gjyqtarëve po zhvarrisin procesin e zgjidhjes së këtyre çështjeve me një aktgjykim të formës së prerë. Në shumë raste, prokuroria dhe gjykatat adresojnë në mënyrë selektive çështjet e profilit të lartë. Në shumicën e rasteve prokuroria ngec, nuk sjell dëshmi të forta dhe nuk propozon dëshmitarë për t'u paraqitur para gjykatës, siç ka ndodhur me çështjen 'Pronto'. Duhet të kemi parasysh që vazhdimisht ka pasur shkelje të kodit penal duke mosdëshkuar personat që mbajnë poste të larta në Kosovë si rasti i z. Salih Mekaj dhe z. Emin Beqiri.

Përkundër ngritjes së aktakuzave, aktiviteti shumë i ngadaltë i sistemit gjyqësorë dhe prokurorial, lënë të kuptohet se çështjet e profilit të lartë po trajtohen dobët. Sipas monitorimit të Drejtësisë Sot, në shumë raste aktakuzat janë ngritur dy vite pasi janë paraqitur kallëzimet penal dhe kanë filluar hetimet. Kjo gjë, sipas Kodit Penal të Kosovës, përbën një shkelje flagrante të afatit të hetimit. Kjo është dëshmuar saktësisht në vendimit të Gjykatës Supreme në rastin e z. Mentor Shamolli (PML,nr.154/17)³². Për më tepër, në disa raste të profileve të larta si rastet e Salih Mekajt dhe Emin Beqirit, Gjykata e Apelit ka hedhur poshtë aktakuzat ndaj të pandehurve, aktgjykime këto që Gjykata Supreme më pas i vërtetoi si të pabazuara.³³

Drejtësia Sot ka monitoruar një numër të konsiderueshëm të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar të profilit të lartë. Rastet e paraqitura më poshtë pasqyrojnë rastet e profilit më të lartë, të cilat janë monitoruar gjatë periudhës kohore qershor – shtator të vitit 2019.

Rasti Pronto (PKR.nr.90/18)

Me rastin e publikimit të disa përgjimeve në gazetën online "Insajderi", si dhe në bazë të Memorandumit të EULEX-it të datës 05 gusht 2016 në të cilin është shprehur mendim se përgatitja e përgjimeve nga gazeta online "Insajderi" paraqet bazë për fillimin e hetimit, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka hapur hetimet. Si rrjedhojë, me datë 15 gusht 2016 ka kërkuar nga EULEX-i që ti sjell CD-të e përgjimeve që i referohen Adem Grabovcit, të realizuara në kuadër të një hetimi nga prokurori i EULEX-it.³⁴

³² Gjykata Supreme e Kosovës, "Aktgjykim-PML.nr. 154/17", të datës, 27.06.2017.

³³ Aktgjykimet e Gjyqës Supreme lidhur me çështjen e Emin Beqirit dhe Salih Mekajt

³⁴ Aktakuza PPS.nr.45/2016 e datës 06.04.2018, paragrafi i parë i arsytimit, faqe 14.

Më 06.04.2018, pas shumë vonesave, Prokuroria Speciale ngriti aktakuzë për shkelje të statusit të barabartë të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës nga neni 193 në lidhje me nenin 28 të KPRK-së ndaj të pandehurve: ish-deputetit Adem Grabovcit, ish- ministrit të Ministrisë së Inovacionit Besim Beqaj, ish- deputetit Zenun Pajaziti, dy ish sekretarëve të përgjithshëm Ilhami Gashi dhe Xhavit Dakaj, ish-zëvendësministrit Fatmir Shurdhaj, këshilltarit politik në Ministrinë e Punëve të Brendshme Sadat Gashi, ish drejtorit të bordit të ndërmarrjes publike 'Radoniqi-Dukagjini' në Gjakovë Ismet Neziraj, ish drejtorit të bordit të ndërmarrjes publike 'Hidro-Drini' në Pejë Rexha Abazi, ish-kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit Nijazi Kryeziu dhe ish shefes së Njesisë për furnizim në Ministrinë e Drejtësisë Arbenita Pajazitit.

Ky rast trajton çështjen e punësimeve dhe ndarjes së posteve bazuar në përkatësinë partiake dhe i njëjti paraqet njërin ndër skandalet dhe aferat korruptive më të mëdha në Kosovë, e i cili kërkon një standard të lartë profesionalizmi dhe përgatitje ligjore. Për fat të keq një gjë e tillë deri me tani nuk është aplikuar.

Së pari, aktakuza e ngritur në këtë rast fillimisht u adresua në Departamentin e Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore të Prishtinës. Pastaj u vendos që kjo lëndë të trajtohet në Departamentin e Përgjithshëm të kësaj Gjykate. Ky veprim cilësohet të jetë ndërmarrë për të relativizuar situatën dhe për të i'a ulur rëndësinë e krimit që gjykohet. Pastaj, me anë të ankesës së Prokurorisë Speciale, Gjykata e Apelit vendosi që çështja të trajtohet nga Krimet e Rënda.

Së dyti, në seancën e mbajtur më 21.12.2018, prokuroria e rastit, znj. Drita Hajdari, kishte kërkuar që e njehta të shtyhet meqë ajo kishte parashtruar kërkesë për inicimin e hetimit disiplinor ndaj kryetarit të trupit gjykues z. Shasivar Hoti. Vlen të përmendet që edhe para kësaj seance, seancat në këtë rast ishin shtyer meqë prokurorja kishte kërkuar përjashtimin e z. Hoti nga trupi gjykues, kërkesë kjo që nuk i ishte aprovuar. Të gjitha këto kërkesa kanë ndikuar në tejzgjatjen e procedurave gjyqësore në këtë rast. Për më tepër, në aktakuzën e ngritur nuk ceket asnjë palë e dëmtuar nga krimi që supozohet që është konsumuar. Poashtu, njëra ndër mangësitë procedurale që e karakterizon këtë rast është edhe mos propozimi i deritanishëm i dëshmitarëve nga ana e prokurorës.

Prandaj, në bazë të fakteve të lartpërmendura, prokuroria në këtë çështje ka treguar mungesë profesionalizmi në ekzekutimin e detyrave të mandatuara. Kjo situatë domosdoshmërisht do të ndikojë në zvarritjen e rastit e cila pastaj do të pasqyrohet në vendimin final të gjykatës.

Rasti i vizave (PKR.nr.305/16)

Rasti i vizave i referohet aktakuzës së Prokurorisë Speciale e cila e akuzon Ukë Rugovën, djalin e ish-presidentit Rugova, se gjatë periudhës maj 2011 deri në shkurt 2014 ka menaxhuar një grupi kriminal, duke furnizuar individë me viza shengen të BE-së nëpërmjet Ambasadës Italiane në Prishtinë. Të gjitha këto viza dyshohet se janë marrë në mënyrë të paligjshme nëpërmjet shtrembërimit dhe korrupsionit. Më 16.05.2016 Prokuroria Speciale ngriti aktakuzë për Krim të Organizuar (Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal) nga neni 283 par 1 i KPK-së, në lidhje me veprën penale Kontrabandimi të migrantëve, nga neni 170 par 1 të KPK-së dhe veprën penale Kontrabandimi të migrantëve (Dokumente mashtruese të Udhëtimit) nga neni 170 par 2 të KPK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 i KPK-së kundër të pandehurve: Ukë Rugovës, Izet Beqirit, Florjan Petanit, Qefser Bahollit, Astrit Haraqijut, Fitim Beqirit, Azad Beqirajt, Liridona Beqirit, Kujtim Avdyllit, Ragip Gashit, Visar Beqirit, Hamza Beqirit, Azem Koskovit, Edison Idrizajt, Beg

Shaqirit, Hasan Shaqirit, Driton Vocas, Valon Selimit, Fadil Ahmetit dhe Haxhi Islamit. Ky rast fillimisht është trajtuar nga prokurori i EULEX-it, Allen Cansick i cili ka theksuar se Prokuroria Speciale ka pranuar nga Prokuroria Italiane në Romë një kopje të dosjes së tyre lidhur me vizat ku përfshihet edhe emri i ish – ambasadorit Italian në Kosovë Michael Giffoni. Rasti në Janar të vitit 2018 kishte kaluar tek gjyqtarët vendor.

Njëjtë si rastet tjera të profilit të lartë, edhe ky rast karakterizohet me një sërë shkeljes procedurale. Së pari, meqë aktakuza ishte ngritur më 18.05.2016, në bazë të nenit 242 pika 4 e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës. Ky afat ligjor është shkelur në mënyrë të vazhdueshme nga ana e trupit gjykues të udhëhequr nga gjykatësi i EULEX-it. Shqyrtimi i parë në këtë rast është caktuar më 25.08.2016, apo mbi tre muaj pas ngritjes së aktakuzës i cili pastaj është shtyer disa herë.³⁵

Së dyti, seanca e fundit për këtë rast, pas konfirmimit të aktakuzës, ishte mbajtur më 22.11.2017. Deri më 14.06.2019, nuk është mbajtur asnjë seancë tjetër, pasi sipas gjykatës, kjo lëndë nuk hyn në grupin e lëndëve me prioritet. Me datë 14.06.2019, është caktuar të mbahet shqyrtimi kryesor ndaj Ukë Rugovës dhe të tjerëve, mirëpo kjo seancë nuk është mbajtur për arsye se kanë munguar të akuzuarit Florjan Petani, Adem Koskoviku, Fadil Ahmeti, Hasan Shaqiri dhe Beg Shaqiri. Me 03.07.2019, është mbajtur seanca gjyqësore për këtë çështje, ku në këtë seancë është veçuar procedura ndaj pesë (5) të akuzuarve të parë në këtë rast: Ukë Rugova, Izet Beqiri, Florjan Petani, Qefser Baholli, Astrit Haraqija, dhe ndaj të njejtëve është lexuar aktakuza.³⁶ Rrjedhimisht, mund të përfundohet që gjykata vazhdimisht e ka neglizhuar trajtimin e këtij rasti, duke mos e konsideruar rast me prioritet për gjykatën dhe duke dështuar në luftimin e krimit dhe korrupsionit në Kosovë.

Rasti 'Toka' (PKR.nr.610/16)

Ky rast trajton pretendimin e Prokurorisë Speciale se me qëllim të përfitimit material, personat e akuzuar kanë tjetërsuar tokat me pronësi shoqërore në Veternik e Llapnasellë. Sipas aktakuzës, ata kanë korrumpuar njerëz nga gjyqësori dhe zyrtarë komunal duke marrë vendime në bazë të të cilëve kanë falsifikuar dokumente me të cilat kanë shitur parcelat te palët e treta.

Më 24.10.2016 Prokuroria Speciale ngriti aktakuzë për pjesëmarrjen ose organizimin e një grupi të organizuar kriminal sipas nenit 283, par.1 ndaj të pandehurve ish-deputetit Azem Syla, Shaban Sylës, Shpresim Ukës, Fahredin Gashit, Ramadan Ukës, Arton Vilës, Avdyrrahim Brajshorit, Gazmend Gashit, Sabedin Haxhiut, Nuhi Ukës, Ilaz Sylës, Ljubisha Vujovic, Hajrullah Berishë; për Mashtrim sipas nenit 355 ndaj të pandehurve Azem Syla, Shaban Syla, Shpresim Uka, Hajrullah Berisha, Ramadan Uka, Ljubisha Vujovic, Gazmend Gashi; për shpërlarje parash sipas nenit 308, par.1 ndaj të pandehurit Fahredin Gashi; për lëshimin e vendimeve gjyqësore të kundërligjshme sipas nenit 432 dhe

³⁵ Drejtësia Sot, "Pas më shumë se një viti e gjysmë filloi gjykimi ndaj ish deputetit Ukë Rugova dhe të tjerëve" burimi <http://www.rolpik.org/pas-me-shume-se-nje-vit-e-gjysme-filloi-gjykimi-ndaj-ish-deputetit-uke-rugova-dhe-tjereve-ne-rastin-e-njohur-me-viza-italiane/>.

³⁶ Veçohet procedura ndaj pesë të akuzuarve të parë në rastin vizat, Drejtësia Sot, 2019, (shih linkun: <http://www.rolpik.org/vecohet-procedura-ndaj-pese-te-akuzuarve-te-pare-ne-rastin-vizat/>).

shpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar sipas nenit 422, par.1, ndaj të panderhuve Azem Syla, Shaban Syla, Shpresim Uka, Hajrullah Berisha, Gazmend Gashi, Ramadan Uka.³⁷

Pas më shumë se dy vite dëgjimesh të dështuara, seanca e parë gjyqësore u mbajt në qershor të vitit 2019 kur edhe u mbajt fjalimi hyrës i prokurorisë dhe i të pandehurve.³⁸ Gjatë kësaj seance, prokurori i shtetit përmendi emrat e dy dëshmitarëve, për të cilët nuk ekziston asnjë vendim ose interpretim konkret nga prokuroria dhe gjykata nëse të njejtit janë dëshmitarë të mbrojtur apo bashkëpunues. Në faza të ndryshme të procedurës si dhe në seanca të ndryshme të mbajtura, këtyre dëshmitarëve u janë drejtuar ose si dëshmitarë të mbrojtur ose si dëshmitarë bashkëpunues, gjë e cila ka krijuar një hutitë të madhe dhe për publikun dhe për palët. Fatkeqësisht, emrat e tyre janë tashmë të njohur për publikun. Publikimi i tyre vlerësohet të ketë dëmton rëndë rastin edhe nëqoftëse të njejtit janë dëshmitarë të mbrojtur. Njëkohësisht ka arritur të dëshmojë moskoordinimin dhe jo përgatitjen e prokurorisë në trajtimin e rasteve më të rëndësishme në Kosovë.

Më pastaj, seanca e ardhshme gjyqësore u zhvillua në shtator të vitit 2019, por dështoi përsëri, për shkak të mungesës së avokatit të të pandehurit Gazmend Gashit.³⁹ Ndërsa seanca e datës 11.09.2019, u procedua prapa dyerve të mbyllura. Gjyqtari i rastit, Beqir Kalludra, mbylljen e seancës nuk e ka arsyetuar me aktvendim të shkruar. I njejtë ka dhënë vetëm urdhër që salla të lirohet nga të gjithë përveç palëve ndaj të cilëve po zhvillohet procedura. Arsye për mbyllje u përmend vetëm dhënia e dëshmisë nga ana e njërit prej dëshmitarëve kryesor për të cilin as gjykata e prokuroria nuk e kanë të qartë nëse është dëshmitar i mbrojtur apo dëshmitar bashkëpunues.

Praktika të tilla të krijuara nga gjykata në njërin anë me mbylljen e seancave pa aktvendim të shkruar, dhe nga prokuroria dhe avokatët në anën tjetër me publikimin e emrave të dëshmitarëve bashkëpunues, respektivisht me mosprezencën e tyre në seanca, degradon totalisht sistemin e drejtësisë në Kosovë dhe shkel çdo rregull të vendosur për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në vend.

Rasti i Veteranëve të Luftës

Detajet e këtij rasti janë trajtuar më lartë në analizë, ndërsa ajo çfarë vlen të analizohet është fakti që më 24.06.2019, Prokuroria Speciale propozoi që të ndërpritet pagesa e pensioneve të fituara në mënyrë të kundërligjshme deri në fund të procedurës penale. Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin PKR.nr.230/18, të datës 26.03.2019, ka refuzuar këtë masë duke treguar kështu mungesë guximi për tu përballur me parandalimin e dëmtimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës, sidomos kur ai është i lidhur me figura të fuqishme në kontekstin aktual të Kosovës.

Rasti i Fajdeve

Të dyshuarit, Ismet Osmani (Curri), Ilir Bojku, Mentor Maqani, Fadil Thaqi dhe Rrahim Hashimi i njohur si grupi i "Fajdeve", janë ende nën hetim për rastin famëkeq të operacionit "Dallga" për të cilin të pandehurit dyshohen për vepra penale si përfitim, mashtrim dhe detyrim. Përveç operacionit të tyre në Kosovë, ky grup dyshohet se ishte i përfshirë në krimin e organizuar edhe në Republikën Çeke. Rasti "Curri" ka tërhequr vëmendjen e publikut ngase anëtarët e këtij grupi dyshohen se kanë lidhje

³⁷ Drejtësia Sot, "Rasti Toka del para gjykatës", (25.06.2019), burimi: <http://www.rolpik.org/rasti-toka-del-para-gjykatës/>

³⁸ Ibid.

³⁹ Drejtësia Sot, "Dështon gjykimi në rastin toka" (05.09.2019), burimi: <http://www.rolpik.org/dështon-gjykimi-ne-rastin-toka/>

të forta me disa figura të larta politike të Kosovës. Sidoqoftë, ende nuk është ngritur ndonjë aktakuzë nga prokuroria. Prokurori i rastit z. Armend Hamiti ka kërkuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës paraburgim për të dyshuarit, me arsyetimin se të dyshuarit do të shkatërrojnë, fshehin, ndryshojnë ose falsifikojnë prova të veprës penale ose rrethana specifike duke ndikuar në dëshmitarët, palët e dëmtuara ose bashkëpunëtorët. Për rrjedhojë, në maj të vitit 2019 gjyqtari i procedurës paraprake të Gjykatës Themelore të Prishtinës ka urdhëruar ndalimin për një periudhë prej një (1) muaji për katër të dyshuarit e parë ndërsa kërkesën për paraburgim për të dyshuarin Rrahim Hashimi e ka refuzuar.⁴⁰ Sidoqoftë, në korrik të vitit 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë u vazhdoi paraburgimin edhe për dy (2) muaj të tjerë të dyshuarve Ismet Osmanit “Curri”, Ilir Bojkut, Mentor Maqanit dhe Adil Thaqit. Në korrik 2019, Gjykata e Apelit e Kosovës krahas ankesës së avokatëve mbrojtës, vendosi t’i kthejë në rishqyrtim vendimet e marra nga Gjykata Themelore e Prishtinës të datës 17.01.2019 dhe 19.01.2019, më saktësisht vendimet për vazhdimin e paraburgimit të të dyshuarve. Sipas vendimit të Gjykatës së Apelit, Gjykata Themelore nuk kishte arsye të mjaftueshme ligjore për vazhdimin e paraburgimit. Ndërsa, me datë 20.09.2019 është vazhduar masa e paraburgimit edhe për 30 ditë ndaj Ismet Osmanit (Curri), Mentor Maqanit dhe Ilir Bojkut.⁴¹ Kështu, mbetet akoma të shihet se si institucionet do të veprojnë në vijim për ta trajtuar këtë rast.

Rasti Shukri Buja (PKR. 206/19).

Më 13.02.2017, Prokuroria Speciale ngri aktakuzë kundër Shukri Bujës, Nebih Zeqirit, Halit Gashit, Magbule Sadikut, Fahri Retkocerit, Hasim Viseshella, Edmond Rexhepit, Driton Avdiut, Burim Kodrës dhe Bajram Rizanit. Gjykata Themelore e Prishtinës, me vendimin e saj PKR.nr.53 / 17 të datës 05.11.2018 ka shpallur fajtor të akuzuarin Shukri Bujën dhe Nebih Zeqirin, për veprën e ‘shpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar’ sipas nenit 422 par. 1 i lidhur me nenin 31 të Kodi Penal të Republikës Kosovës. Ndërsa i akuzuari Hasim Viseshella u shpall i fajshëm në veprën penale të ryshfetit sipas nenit 343 par. 1 i Kodit Penal, si në pikën 2.4 të aktakuzës. Ngjashëm, i akuzuari Bajram Rizani, është shpallur fajtor për veprën e ‘abuzimit të pozitës apo autoritetit zyrtar’ sipas nenit 422 par. 1 i KPRK-së, si në dispozitivin 2.6 të aktakuzës. Gjykata Themelore e Prishtinës dënoi Shukri Bujën me 3 vjet burgim, Nebih Zeqirin me 2 vjet e 6 muaj, Halit Gashin me 6 muaj burgim ose me gjobë prej 3.500 Eurove, Edmond Rexhepin me 6 muaj burgim ose me gjobë prej 3.500 Euro, Hasim Viseshellën me 5 muaj burgim apo gjobë 2.900 euro, Bajram Rizani me 6 muaj burgim ose me gjobë prej 3.500 Eurove.

⁴²

Më 26.08.2019, Gjykata e Apelit, rishikoi të gjitha dokumentet në lidhje me këtë rast. E njehta shqyrtoi aktgjykimin e apeluar në përputhje me parashikimin e nenit 394 par. 1 i Kodit të Procedurës Penale, dhe pasi kishte vlerësuar pretendimet e paraqitura në ankesa, konstatoi se: “Aktgjykimi përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale të cilat kushtëzojnë anulimin e aktgjykimit dhe kthimin e tij në rivendosje”. Ky është një nga shumë rastet ku sistemi i drejtësisë së Kosovës nuk arrin të ndëshkojë dhe të dënojë figura të fuqishme politike.

⁴⁰ Indeks online, Komunikatë për shtyp, burimi: <https://indeksonline.net/gjykata-konfirmon-vendimin-per-currin-dhe-te-tjeret/>

⁴¹ Drejtësia Sot, “30 ditë të tjera paraburgimi ndaj të dyshuarve për fajde” (20.09.2019), burimi: <http://www.rolpik.org/30-dite-te-tjera-paraburgimi-ndaj-te-dyshuarve-per-fajde/>

⁴² Drejtësia Sot, “Kthehet në rigjykim rasti i Shukri Bujës, ish-kryetarit të komunës së Lipjanit/ (26.08.2019), burimi: <http://www.rolpik.org/kthehet-ne-rigjykim-rasti-i-shukri-bujes-ish-kryetarit-te-komunes-se-lipjanit/>

Rastet e lartpërmendura paraqesin vetëm disa raste relevante të rëndësishme për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar në Kosovë. Për më tepër, këto raste pasqyrojnë qartë se si institucionet e drejtësisë trajtojnë rastet me peshë të madhe për procesin e integritetit të Kosovës, përkatësisht procesin e liberalizimit të vizave.

4. AKTAKUZAT E NGRITURA PËR RASTET E PROFILIT TË LARTË TË KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Drejtësia Sot gjatë muajve qershor-gusht 2019, ka monitoruar aktakuzat e paraqitura për rastet e profilit të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Janë monitoruar edhe raste të tjera që janë në kompetencën e PSRK-së.

Duhet të theksohet se, Prokuroria Speciale nuk ka ngritur aktakuzë kundër Presidentit Thaçi, i cili dyshohet se ka keqpërdorur paratë publike për ta shkruar dhe promovuar librin e tij autobiografik. Sipas kryeprokurorit të shtetit, z. Lumezi, ky rast është hetuar dhe mbyllur nga prokuroria në mungesë të provave. Për më tepër, nuk dihet a është duke vazhduar procesi penal kundër Nazim Sahitit, i cili dyshohet të jetë i përfshirë në sulmin ndaj kreut të Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës (Vala). Këto dy raste janë një shembull se si Prokuroria e Shtetit po dështon në ndjekjen e krimeve të nivelit të lartë në Kosovë.

Për më tepër, aktakuzat e pabazuara dhe të paqarta vazhdojnë të jenë një çështje shqetësuese. Sipas jurisprudencës dhe ligjeve në fuqi, aktakuza duhet të jetë koncize dhe të aludojë në fakte të qarta. Ka pasur shumë raste kur prokuroria nuk e mbështet aktakuzën me prova të qarta. Kemi rastin Pronto, një nga rastet më të larta të korrupsionit, ku prokurorja nuk ka arritur t'i paraqes dëshmitë përkatëse kundër të pandehurit.⁴³ Mungesa e profesionalizmit të saj u vu në dukje nga kryetari i trupit gjykues, Shahsivar Hoti, dhe vlerësohet se një lëshim i tillë do ta ndikojë negativisht të gjithë rastin.⁴⁴

Një veprim pozitiv i punës së Prokurorit të Shtetit ka qenë aktakuza e ngritur për veprën penale 'shpërlarje parash', nga prokurori i Prokurorisë Speciale, Atdhe Dema, kundër të pandehurve Ramadan Mavrajt, Muharrem Mavrajt, Flamur Mavrajt, Xhelal Kastratit, Valdet Muriqit dhe Rexhë Kastratit. Ende nuk dihet se si gjykata do t'a gjykojë këtë rast kaq të ndjeshëm, kur të akuzuarit njihen si përfitues të tenderëve/fondeve publike.⁴⁵

Për më tepër, gjatë qershorit, korrikut dhe gushtit 2019, Prokuroria Speciale ka ngritur vetëm një aktakuzë kundër nëntëmbëdhjetë (19) personave për krimin e organizuar dhe një aktakuzë për shpërlarje parash kundër gjashtë (6) personave. Gjithashtu, Prokuroria Themelore e Prishtinës gjatë muajit qershor, korrik dhe gusht 2019 ka ngritur dy aktakuza kundër katër (4) personave për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autoritetit sipas nenit 422 të Kodit Penal, dhe një aktakuzë për keqpërdorim të detyrës sipas nenit 418 të Kodit Penal të ri. Prokuroria Themelore e Prizrenit poashtu gjatë muajit qershor, korrik dhe gusht 2019 ka ngritur gjashtë (6) aktakuza për keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar sipas nenit 422 të Kodit Penal, nga të cilat pesë (5) persona janë drejtorë ose

⁴³ Drejtësia Sot, "Prokuroria nuk propozon asnjë dëshmitarë në rastin Pronto" (26.06.2019), burimi: <http://www.rolpik.org/prokuroria-nuk-propozon-asnje-deshmitare-ne-rastin-pronto/>

⁴⁴ Id.

⁴⁵ Koha.net, 'Të akuzuarit për shpërlarje parash përfitues të tenderëve publik', (22.08.2019), burimi: <https://www.koha.net/kronike/180320/te-akuzuarit-per-shpelerarje-parash-perfitues-te-tenderëve-publik/>

ish-drejtorë komunal në Prizren. Nga ana tjetër, Prokuroria Themelore e Gjilanit, Ferizajt, Gjakovës dhe Pejës nuk kanë ngritur asnjë aktakuzë në lidhje me këto vepra penale për periudhën në fjalë.

Sipas statistikave të mësipërme, ekziston një numër i vogël i aktakuzave për çështjet e profilit të lartë. Edhe ato pak aktakuzat të paraqitura duhet të jenë më cilësore në mënyrë që para gjykatës rastet të paraqiten më profesionalisht. Janë ngritur një numër i aktakuzave kundër zyrtarëve të vjetër, megjithatë në të kaluarën është treguar se shumë nga këto aktakuza janë hedhur poshtë nga gjykata. Shpesh për shkak të mungesës së dëshmive ose cilësisë joprofesionale të aktakuzës. Në shumë raste, ata nuk përfshijnë të gjitha pikat e parapara në Kodin e Procedurës Penale, gjë që reflekton mungesën e profesionalizmit bazik.

Ka shumë raste kur aktakuza shkon në seancën e parë, por rëndom në rastet e profilit të lartë prokuroria pas ngritjes së aktakuzave tërhiqet, sikurse në rastin e ish-deputetit të parlamentit z. Pal Lekajt dhe ish-kreut të Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës (AKI-së) z. Driton Gashit. Prokuroria e tërhoqi aktakuzën kundër të pandehurit pas fillimit të gjykimit pa ndonjë arsye të vlefshme. Për t'u mos përsëritur ngjarjet e lartpërmendura, prokuroria duhet t'i trajtojë aktakuzat e profilit të lartë me guxim, seriozitet dhe paanshmëri.

5. SHKELJET LIGJORE DHE TEKNIKE GJATË GJYKIMEVE NGA GJYKATAT

Drejtësia Sot ka monitoruar nga afër seancat gjyqësore në të gjitha gjykatat themelore të Kosovës dhe Gjykatën e Apelit në Prishtinë, me qëllim që t'i identifikojë mangësitë në sistemin e drejtësisë dhe t'u bëjë thirrje për t'i kushtuar më tepër vëmendje çështjeve që po pengojnë sistemin e drejtësisë. Lista më poshtë paraqet shkeljet e identifikuar nga monitoruesit e Drejtësia Sot të natyrës teknike dhe ligjore nga akterët gjyqësorë brenda Gjykatës Themelore të Prishtinës për periudhën qershor - gusht 2019.

Shkeljet e ligjit të procedurës penale nga gjyqtarët gjatë seancave gjyqësore:

Ka shumë raste të shkeljeve të ligjit të procedurës penale nga gjyqtarët gjatë gjykimeve. Është raportuar se në shumë raste aktakuza nuk i është lexuar të akuzuarit, veprim që është në kundërshtim me ligjin. Në çështjen e profilit të lartë "Toka", prokurori special z. Naim Abazi ka kryer një shkelje të dukshme të ligjit të procedurës penale, duke përmendur emrat e dy dëshmitarëve të mbrojtur,⁴⁶ një gabim që mund t'i vë në rrezik ata dhe t'a pengojë seriozisht ecurinë e rastit. Shqetësuese është poashtu mungesa e koordinimit mes gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me një çështje. Në disa raste, mungesa e koordinimit ndërmjet gjykatësit dhe prokurorit të çështjes ka shkaktuar mosmbajtjen e seancës gjyqësore. Vlen të përmendet rasti i të akuzuarit Aziz Tafajt, ku për dy herë radhazi gjykata nuk arriti ta mbajë seancë për shkak të mungesës së prokurorit si dhe mungesës së anëtarëve të trupit gjykues.⁴⁷ Për më tepër, kemi rastin e Milaim Zekës, ku një nga anëtarët e trupit gjykues nuk u paraqit, dhe si rezultat seanca është shtyer.⁴⁸

⁴⁶ Kallxo.com, 'Në gjykimin ndaj Azem Sylës zbulohen emrat e dëshmitareve të mbrojtur', (25.96.2019), burimi: <https://kallxo.com/shkurt/skandal-ne-gjykimin-ndaj-azem-syles-zbulohen-emrat-e-deshmitareve-te-mbrojtur/>

⁴⁷ Drejtësia Sot, "Dështon gjykimi ndaj biznesmenit Aziz Tafajt", (16.98.2019), burimi: <http://www.rolpik.org/desh-ton-gjykimi-ndaj-biznesmenit-aziz-tafaj/>

⁴⁸ Drejtësia Sot, "Mungon anëtarja e trupit gjykues, shtyhet seanca ndaj Milaim Zekës", (10.07.2019), burimi: <http://www.rolpik.org/mungon-anetarja-e-trupit-gjykues-shtyhet-seanca-ndaj-milaim-zekes/>

Problemet si vonesat dhe parregullsitë në mbajtjen e seancave gjyqësore janë prezente në të gjitha gjykatat e Kosovës, shembull konkret është rasti i njohur me emrin 'Stentat'. Janë të pakta rastet kur seancat gjyqësore fillojnë në kohën e përcaktuar. Në shumë raste seancat gjyqësore fillojnë shumë me vonesë për shkak të vonesave të anëtarëve të trupit gjykues, prokurorit të shtetit apo ndonjëherë edhe të pandehurve të mbajtur në qendrat e paraburgimit. Për shembull, kemi rastin e Enver Sekiraqës ku seanca ishte caktuar për datën 11.06.2019. Gjykata harroi të paraqes kërkesën për transportimin e të pandehurit Enver Sekiraqës nga burgu për në objektin e gjykatës. Kur gjykatës i'u kujtua, atëherë transporti i burgut nuk mund t'a sillte të pandehurin për shkak të informimit me vonesë.

Së fundi, kemi rastin "Syri i Popullit", ku Presidenti Thaçi ishte ftuar të dëshmoj lidhur me rastin në cilësinë e të dëmtuarit për të marrë në pyetje të akuzuarin Sadri Ramabaja. Ai parashtronte pyetje të drejtpërdrejta dëshmitarëve, gjë që nuk lejohet, dhe sjellja e tij gjatë seancës ishte arrogante. Ai fyente avokatët dhe palët e tjera, ndërsa për sjelljet e tij asnjëherë nuk i'u tërhoq vërejtja nga kryetarja e trupit gjykues Naime Krasniqi Jashanica. Gjithashtu me propozimin e presidentit dhe të prokurorit special seanca vazhdoi me dyer të mbyllura, ku të pranishëm në seancë ishin vetëm monitoruesit.⁴⁹

Shkelja e parimit të publicitetit: Parimi i Publicitetit siguron transparencën e gjykatës për të promovuar besimin e qytetarëve që marrin pjesë në gjykim. Sipas informacioneve, në shumë raste për shkak të sallave të vogla gjyqësore, anëtarët e familjes së të pandehurve i'u ndalohej pjesëmarrja në seancën gjyqësore për shkak se numri i ulëseve është i kufizuar. Në lidhje me këtë, kemi rastin e Bujar Behramit, ku anëtarët e familjes së tij u ndaluan të merrnin pjesë në seancë për shkak të numrit të kufizuar të ulëseve. Gjithashtu, një problem tjetër që çënon parimin e publicitetit është mos botimi i orareve të seancave në faqen zyrtare të gjykatës. Duke pasur parasysh që Gjykata Themelore e Prishtinës ka fluksin më të madh të çështjeve që presin të gjykohen, është shumë e rëndësishme që të informohet publiku për datën dhe kohën e seancës dëgjimore. Vetëm një përqindje e vogël e seancave gjyqësore janë botuar në faqet zyrtare të gjykatës, dhe kjo varet nga gjykatësi. Në shumicën e rasteve, publiku i interesuar njoftohet përmes rojtarëve të gjykatës të cilët mbajnë regjistrat të këtyre seancave. Poashtu ekziston mungesa e koordinimit midis gjyqtarëve lidhur me rezervimin e sallave për gjykime. (Rastet e datës 23.08.2019 me gjyqtarët Valon Kurtaj dhe Lutfi Shala). Për më tepër, ky problem është i pranishëm në të gjitha gjykatat e tjera në Kosovë.

Gjithashtu, duhet të theksohet se Gjykata Themelore e Mitrovicës nuk ka fare zyrtar për informim, përgjegjës për botimin e orarit të seancave gjyqësore. Natyrisht, mospublikimi i vendimeve të nxjerra nga gjykata është një praktikë e dëmshme për të cilën duhet marrë masa të shpejta nga të gjitha gjykatat në Kosovë. Publikimi i gjykimeve në faqet e internetit të gjykatave mundëson qasjen në të dhëna, ngrit vetëdijën e përgjithshme si dhe rrit besimin në sistemin gjyqësor të Kosovës. Sidoqoftë, shumica e vendimeve përfundimtare nuk publikohen në faqet e internetit të Gjykatave Themelore. Pra, vështirësitë në qasjen në dokumentet zyrtare të gjykatave, paraqesin një sfidë mjaft të madhe. Në shumë raste, Drejtësia Sot ka hasur në shumë vështirësi për të pasur qasje në dokumente zyrtare. Përgjigjet për kërkesat e tilla nuk merren me kohë apo janë të mangëta ngase nuk i'u përgjigjen të gjitha pikave të kërkesave. I njëjti shqetësim ekziston edhe për gjyqtarët dhe prokurorët, pasi shumë prej tyre refuzojnë të japin informatat e nevojshme gjatë monitorimit.

⁴⁹ Informata të mbledhura nga monitoruesit në terren.

6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në këtë raport, kemi analizuar procesin e vendimmarrjen të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK-së) dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK-së), si dy institucione kryesore gjyqësore që koordinojnë punën e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në tërë Kosovën.

Për periudhën qershor - shtator 2019, KGJK-ja nuk ia doli të sigurojë një proces transparent dhe të ligjshëm për emërimin e gjyqtarëve në Departamentin Special. Emërimi i gjyqtarëve në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit u realizua nëpërmjet një procesi të fshehur, të mbajtur larg nga kontrolli publik, duke shkelur parimet kushtetuese të transparencës dhe përgjegjshmërisë. Në anën tjetër KPK-ja gjatë emërimit të Ushtruesit të Detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Prishtinës, ka shkelur kornizën ligjore duke mos i'u përmbajtur Rregullores në fuqi.

Për më tepër, mosmarrja e masave nga KGJK-ja kundër gjyqtarëve jo kompetent që kanë bërë shkelje të ligjit po dobësojnë edhe më tutje besimin e qytetarëve për organet e drejtësisë. Ekzistojnë një numër rastesh që tregojnë se KGJK-ja nuk ka ndërmarrë ndonjë hap konkret për të siguruar se gjyqtarët që shkelin ligjin të shkarkohen apo edhe të disiplinohen nga këshilli. Një situatë si kjo jo vetëm që dëmton drejtësinë duke i mosndëshkuar thyesit e ligjit, por po kontribon në krijimin e një sistemi të atillë ku nuk merren masa disiplinore ndaj gjyqtarëve.

Drejtësia Sot ka monitoruar nga afër punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve në tërë Kosovën. Gjetjet gjatë monitorimit zbulojnë mangësi të jashtëzakonshme në trajtimin e rasteve të caktuara të korrupsionit dhe krimit të organizuar, zgjidhja e së cilave është e ndërlidhur ngushtë me procesin e liberalizimit të vizave. Shkeljet teknike dhe ligjore të ligjeve në fuqi ndodhin në baza ditore nga gjyqtarët dhe prokurorët gjatë procedurave gjyqësore, çka tregon edhe një herë se gjyqësori ende nuk po ia del të sigurojë një sistem gjyqësor të pavarur, të përgjegjshëm dhe efikas në Kosovë.

Rrjedhimisht, në bazë të gjetjeve gjatë monitorimit tremujorë mund të konkludohet se institucionet e drejtësisë ende nuk po arrijnë të zbatojnë modele të bazuara në transparencë dhe në meritokraci gjatë emërimit të akterëve kryesorë për luftimin e korrupsionit, krimit të organizuar dhe krimit të nivelit të lartë. Për më tepër, këto institucione përgjegjëse për vendosjen e drejtësisë po e thyejnë vet ligjin për qasje në dokumente publike, duke mos siguruar respektimin e parimit të publicitetit dhe ndjekjen e procedurave gjyqësore ashtu siç e parasheh ligji.

Për të trajtuar çështjet e gjetura në këtë raport, Drejtësia Sot jep këto rekomandime:

- 1) KGJK-ja si institucion kushtetues duhet të jetë një shembull i rritjes së nivelit të transparencës dhe respektimit të ligjit gjatë proceseve të emërimit të personave në poste kyçe në organet e drejtësisë. Emërimi i gjyqtarëve në Departamentin Special dhe atë të Apelit me jurisdikcion ankimor për rastet e Departamentit Special duhej të kishte qenë i organizuar në mënyrën më të hapur, ashtu që publiku të bindet që rëndësia dhe kapaciteti i këtyre gjyqtarëve ka qenë i pakontestuar. Vetëm në këtë formë KGJK-ja do të garantonte ushtrimin e mandatit të saj në mënyrë meritore, dhe do të rriste mbështetjen dhe besimin e publikut në degën gjyqësore. Pasojat e kësaj neglizhence do të ndihen seriozisht në sektorin e sundimit të ligjit në tërësi.
- 2) KGJK-ja duhet t'ia mundësojë shoqërisë civile, si mekanizëm promovues i demokracisë, qasjen në të gjitha dokumentet që përcaktojnë metodologjinë, kornizën ligjore, mekanizmin e

shënimit të pikëve, etj., gjatë procesit të emërimit të gjyqtarëve të Departamenteve Speciale. Gjithashtu, KGJK-ja duhet t'i mundësojë shoqërisë civile qasjen në dokumentet publike në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike. KGJK-ja duhet të jetë shembull i hapjes ndaj publikut, e jo pasqyrim i keq i praktikave abuzive të Qeverisë.

- 3) KGJK-ja nuk duhet t'i lë të pandëshkuar, por të ndërmarrë masa specifike kundër gjyqtarëve të përfshirë në nxjerrjen e aktgjykimeve që përmbajnë shkelje të ligjit. Më konkretisht KGJK-ja duhet të ndërmarrë veprime konkrete kundër gjyqtarëve që lëshuan aktgjykime të paligjshme në rastin e Salih Mekajt dhe Emin Beqirit. Në të dyja rastet, përbërja e trupit gjykues ka qenë e njejtë. Përbërja e njejtë e trupit gjykues në të dyja rastet ngrit dyshime për përsëritjen e vazhdueshme të problemit të njejtë. Poashtu, KGJK-ja duhet të marrë masat e parapara disiplinore për të gjithë gjyqtarët për të cilët është vërtetuar që kanë zbatuar në formë korrekte legjislacionin në fuqi. Si në rastet:
 - a. Rasti Mentor Shamolli, vendimi i Gjykatës Supreme (PML,nr.154/17)⁵⁰
 - b. Rasti Berat Nika, Krenare Macula, Nehat Veliu dhe Xhelal Selimi, vendimi i Gjykatës Supreme (PML.nr.99/2018)⁵¹

Të gjitha këto raste dëshmojnë paaftësinë e KGJK-së dhe trupave disiplinore e performuese të saj që të garantojnë integritetin profesional të gjyqtarëve në rastet kur paligjshmëria është evidente dhe për më tepër e konfirmuar katërsipërisht nga një gjykatë e shkallës më të lartë. Asgjë nuk e amnistion një tendencë të heshtjes së KGJK-së ndaj një situatë të tillë.

- 4) KPK-ja duhet të reagojë fuqishëm në rastet kur prokurorët e shtetit linqohen publikisht nga politikanë të lartë, sikur që ishte linqimi i ish Prokurorit Blakaj nga Kryeministri Haradinaj dhe Kryeparlamentari Veseli. KPK-ja nuk mund t'i nënshtrohet kontekstit politik, dhe të paraqitet si organ i heshtur dhe i frikësuar ndaj veprimeve të tilla skajshmërisht jo-etike dhe të kundërligjshme. KPK-ja duhet që gjithashtu prokurorët t'i mbroj me argumente, dhe të marr masa ndaj atyre që bëjnë përpjekje t'i ndikojnë në kundërshtim me ligjin.
- 5) Vonimi i drejtësisë është mohim i drejtësisë. Prandaj veprimet gjyqësore në çështjet e profilit të lartë të korrupsionit dhe krimin të organizuar duhen të rriten dhe seancat duhet të mbahen më shpesh. Ky rekomandim vlen për të gjitha rastet e trajtuara në këtë analizë. Raste të veçuara që hyjnë në këtë kategori të neglizhencës gjyqësore janë rasti Veteranët, Pronto, Rasti i Vizave, Rasti i Fajdeve, Rasti Toka, etj.
- 6) Të gjithë zyrtarët për informim të të gjitha institucioneve të drejtësisë duhet t'a respektojnë Ligjin Nr. 06 / L-081 për Qasjen në Dokumente Publike për të gjitha dokumentet e lëshuara, të pranuar, të mirëmbajtura apo të kontrolluara nga këto institucione. Asnjë përjashtim nga ky parim nuk është i lejuar, sepse sistemi i drejtësisë duhet të jetë shembull i transparencës dhe integritetit në raport me hapjen ndaj publikut.
- 7) Gjyqtarët duhet të mënjanojnë shkeljet e ligjit të procedurës penale gjatë gjykimeve, dhe shkeljet teknike në mënyrë të tillë që ato të mos shndërrohen në faktor që minojnë besimin ndaj sistemit të drejtësisë, përkthësisht:
 - 7.1) Administrata e gjykatës duhet t'i publikojë me saktësi kohën e seancave gjyqësore. Kjo vlen sidomos për administratën e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Mitrovicë. Një publikim

⁵⁰ Gjykata Supreme e Kosovës, "Aktgjykim-PML.nr. 154/17", të datës, 27.06.2017.

⁵¹ Gjykata Supreme e Kosovës, "Aktgjykim PML.nr.99/18", të datës: 14.05.2018

i tillë duhet të bëhet online në ëebfaqen e secilës gjykatë. Një praktikë e tillë do të rriste ndjeshëm mbikqyrjen e publikut ndaj performancës gjyqësore dhe prokuroriale.

7.2) Aktgjykimet e gjykatave duhet të publikohen në faqen zyrtare të KGJK-së në mënyrë që të rritet vetëdija e përgjithshme dhe t'u mundësohet qytetarëve vlerësimi i punës së gjykatave. Megjithëse një numër i madh i aktgjykimeve publikohen, KGJK-ja duhet të garantojë rritjen e përqindjes së tyre.

- 8) Prokurorët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës duhet të ndriqojnë pretendimet dhe akuzat e ngritura nga prokurori Blakaj lidhur me ndërhyrjen e Kryeprokurorit të Shtetit, z. Aleksandër Lumezi si dhe Kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj në hetimin e tij në rastin 'Veteranët'. Një hetim i tillë duhet të jetë shembull i guximit të prokurorisë së shtetit për të parandaluar linqimin dhe ndërhyrjen në sistemin e drejtësisë së figurave të larta politike.
- 9) Në rastin Pronto, si një ndër rastet më të mëdha që involvojnë përfshirjen e figurave të larta politike në ndërhyrjen në punën e prokurorisë, Prokurori i Shtetit duhet të precizojë aktakuzën dhe të bëjë identifikimin e palëve të dëmtuara në atë rast, si dhe të ofrojë një listë dëshmitarësh për rastin. E njëjta gjë duhet bërë edhe në rastin e Veteranëve. Si një shembull krahasues për qëllim të rekomandimeve teknike, gjithashtu, në rastin e njohur si 'Vizat', gjykata duhet të ndërmarrë veprime konkrete procedurale edhe ndaj personave për të cilët është veçuar aktakuza. I njejtë rekomandim vlen edhe për rastin 'Stenta 3'. Gjithashtu, gjykatat themelore duhet të jenë të vetëdijshme që nuk mund të refuzojnë kërkesat për masë të përkohshme kur është plotësisht e evidente dëmi që i shkaktohet buxhetit publik. Refuzimi i masës së përkohshme në rastin Veteranët përbën një shkelje flagrante, dhe dëshmi që dega gjyqësore nuk ka guximin të përballet me një keqpërdorim të tillë evident.



British Embassy
Pristina



Group for Legal
and Political
Studies

